



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 504/2 Prot.

Tiranë, më 27 / 04 / 2018

V E N D I M

Nr. 114, Datë 27.04.2018

Mbështetur në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr.45 Regj., datë 16.04.2018, të Zyrës për Mbrojtjen Ligjore të Fëmijëve dhe të Rinjve në Shqipëri/CRCA, Ambasadës PINK dhe z.K. P, kundër Portalit “Librazhdi Today” dhe Myftisë së Librazhdit, A. H, me pretendimin për diskriminim për shkak të “orientimit seksual” dhe të “identitetit gjinor”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

Z.A. H në tagrin e përfaqësuesit të Zyrës për Mbrojtjen Ligjore të Fëmijëve dhe të Rinjve në Shqipëri/CRCA dhe Ambasadës PINK, në ankesën e sjellë pranë Zyrës së KMD-së infomon për publikimin në një portal “Librazhdi Today”, datë 05.04.2018 të një shkrimi të Myftinisë Librazhd me titull: “Myftinia Librazhd në shkolla: “Ndal propagandës së “kancerit”. Komuniteti “KANCER” nuk mund të shpërndajë asgjë tjetër vetëm KANCER””. Në vijim të ankesës citohet se shkrimi informon: “Në datën 04.04.2018 Myftiu A. H bëri një takim miqësor në shkollën e mesme “Ibrahim Muça” Librazhd. Gjatë takimit u diskutua me drejtoreshën e kësaj shkolle znj.K. L rreth situatës së krijuar nëpër shkollat e kryeqytetit për propagandën e nxitur nga instanca të ndryshme në lidhje me LGBT. Myftiu është shprehur se: “Ata po mundohen të bëjnë pjesë të kulturës degjenerimin e prishjes së traditës njerëzore të bukur që na e ka dhuruar Zoti. Ndal propagandës së “Kancerit”. Komuniteti nuk mund të shpërndajë asgjë tjetër vetëm se

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën: KMD.

kancer”. Z.A. H shprehet se, përmes fjalimit të tij myftiu kërkon përjashtimin nga jeta publike dhe aksesin në institucionet publike, shkonta në këtë rast, për komunitetin LGBTI në Shqipëri. Ai kërkon nga Komisioneri të konstatohet diskriminimi i drejtëpërdrejtë i komunitetit LGBTI në Shqipëri nga ana e Myftiut A. H.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Mbështetur në dispozitat e ligjit 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe në kërkesat e përcaktuara në formularin e aplikimit, në rastin kur ankesa paraqitet nga një organizatë me interesa legjitime, asaj duhet t’i bashkëlidhet kopja e vendimit të gjykatës për krijimin e organizatës, kopja e statutit të organizatës, kopja e kartës së identitetit ose aktin e prokurës së posaçme, për të përfaqësuar personin ose grupin e personave.

Duke qenë se ankesa e sjellë pranë Komisionerit kishte mangësi të anës formale, lidhur me dokumentacionin e nevojshëm për legjitimitimin e saj përpara KMD-së, me datë 12.04.2018, Specialistja e Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun i ka dërguar e-mail z. A. H² dhe z.K. P³, lidhur me plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm.

Në vijim të korrespondencës zyrtare me KMD-në rezultoi se janë paraqitur këto dokumente:

- Kopje e Vendimit nr.2853 i Gjykatës së Rrethit Tiranë, sipas të cilit shoqata “Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri” me datë 16.06.1997 është regjistruar si person juridik.
- Kopje të Vendimit nr.2853/1 datë 16.02.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për depozitimin në regjistrin përkatës pranë kësaj gjykate të dy vendimeve të Bordit të Drejtorëve të shoqatës “CRCA”.
- Kopje e Vendimit nr.701, datë 22.11.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për regjistrimin e qendrës “Ambasada Pink-LGBT Pro Shqipëri”.

Pas verifikimit të dokumentacionit të sjellë pranë KMD-së, Komisioneri vëren se:

Së pari, në formularin e ankesës z.K. P në një nga rubrikat është cilësuar si person kontakti dhe në një rubrikë tjetër të ankesës është cilësuar si person i cili ankohet.

Megjithëse i është kërkuar plotësimi i dokumentacionit (karta identitetit) ankuesi, nuk ka depozituar asnjë dokument identifikues. Pra, nga pikëpamja formale, ankesa nuk plotëson kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

² Në adresat elektronike: a.h@gmail.com; info@crca.al; k.p@crca.al.

³ Cilësuar “person kontakti” në formularin e ankesës.

Së dyti, në vendimin “Për regjistrimin si person juridik të qendrës “Ambasada Pink-LGBT Pro Shqipëri”(regjistruar me datë 22.11.2011) citohet se: *“Drejtori Ekzekutiv është përfaqësues ligjor i qendrës zgjedhur për një periudhë 3-vjeçare”*.

Mëgjithëse objekti i veprimtarisë së qendrës është mbrojtja proaktive e të drejtave të komunitetit LGBT në Shqipëri, lufta kundër diskriminimit të bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor, etj, gjë që do ta legjitimonte “locus standi” organizatën për të paraqitur ankesë në emër të komunitetit për çdo pretendim për diskriminim për këto shkaqe; të drejtën për këtë përfaqësim e ka Drejtori Ekzekutiv i saj.

Mirëpo, referuar Vendimit nr.701, datë 22.11.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është përcaktuar afati 3-vjeçar i Drejtorit Ekzekutiv të kësaj qendre në tagrin e përfaqësuesit ligjor.

Duke qenë se pranë Komisionerit nuk është depozituar asnjë dokument ku të mund të provohet se është zgjatur koha e qëndrimit në këtë pozicion, si Drejtor Ekzekutiv përtej vitit 2014 e deri sot (gjë që automatikisht i jep dhe tagrin e përfaqësimit në emër të gjithë komunitetit), z.A. H nuk mund të legjitimohet në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv të qendrës “Ambasada Pink-LGBT Pro Shqipëria” për të paraqitur ankesë në emër të komunitetit LGBTI.

Së treti, sa i takon legjitimitit të z.A. H si përfaqësues i shoqatës CRCA Komisioneri vëren se:

- Referuar Vendimit nr.2853/1, datë 16.02.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, citohet zgjatja e mandatit të Drejtorit Ekzekutiv, z.A. H (megjithëse nuk është përcaktuar sa është afati kohor i kësaj zgjatjeje).
- Referuar Vendimit nr.2853 i Gjykatës së Rrethit Tiranë, sipas të cilit shoqata “Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri” me datë 16.06.1997 është regjistruar si person juridik, citohet se: *“...Shoqata është krijuar me qëllim kryesor mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve nëpërmjet zbatimit të ligjeve që mbrojnë statutin e fëmijëve duke bashkëpunuar me organet përkatëse shtetërore, administrative ose jo, me organizata të tjera kombëtare e ndërkombëtare”*.

Pra, nga sa shihet nuk provohet lidhja e drejtëpërdrejtë dhe e individualizuar që ekziston mes veprimtarisë së shoqatës dhe qëllimit për të cilin ajo është krijuar si organizatë në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve dhe marrjes së tagrit të përfaqësuesit të komunitetit LGBTI në Shqipëri. Për këtë arsye, z.A. H nuk legjitimohet si përfaqësues i qendrës “CRCA” për paraqitjen e ankesës pranë KMD-së.

Por, Komisioneri vlerëson se problematika e sjellë në vëmendje nga ana e z.A. H prek gjithë komunitetin LGBTI, dhe se një gjuhë e tillë cënon ineresat, dinjitetin dhe të drejtat themelore të tyre, dhe pikërisht parë në këtë prizëm do të shqyrtohet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si çështje e iniciuar kryesisht.

Bazuar në nenin 33, pika 4/b, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nuk përmbushen kriteret e përcaktuara nga ky Ligj, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Referuar nenit 32, pika 1/c të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku citohet se: “Komisioneri ka kompetencë të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të ligjit” si dhe bazuar në informacionin e marrë nga ana e z.A. H, kjo çështje do të ndiqet kryesisht nga zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 7, pika 1, 21, pika 1, neni 32, pika 1, gërma a), si dhe nënenin 33, pika 4, gërma c) dhe ç), të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së paraqitur nga ana e Zyrës për Mbrojtjen Ligjore të Fëmijëve dhe të Rinjve në Shqipëri/CRCA, Ambasada PINK dhe z.K. P; pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në gjykatë, brenda afatit 45 ditor nga marrja dijoni, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurës Administrative, të ndryshuar.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Fusha: Shërbime

Shkaku: Orientimi seksual, identitetet gjinor